



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.641/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj, Skender Çoçaj, Hidajete Gashi Alaj, Hajriz Hoti, Violeta Husaj Rugova dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosjes (LVV) me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/727-2025, të datës 15 Mars 2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 19.03.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa A.nr.641/2025 e datës 17.03.2025 e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosjes (LVV) me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/727-2025, të datës 15 Mars 2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, me të cilën ka kërkuar që të anulohen rezultatet e votimit me postë për subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës dhe kandidatët e saj, gjithsejtë 18933 vota dhe këto vota të largohen nga rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, ta urdhërojë KQZ-në që të përsërisë votimin me postë në tërësi si dhe ti largoj nga lista e kandidatëve të subjektit politik LDK kandidatët të cekur me emër e mbiemër në arsyetimin e kësaj ankese, për shkak të manipulimit me vota të ardhura me postë dhe të mos e lejojë subjektin politik LDK ti zëvendësoj kandidatët e larguar.

A r s y e t i m

Me datë 17.03.2025 PZAP ka pranuar ankesën me numër Anr.641/2025, të parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, ku bazuar në nenin 106, paragrafi 3 të LZP-së, është kundërshtuar Vendimin Nr.01-727-2025, datë 15 Mars 2025 të KQZ-së, që ka të bëjë me shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, me vlerësim se fletëvotimet e ardhura me postë në Kosovë, pretendojnë se janë manipuluar, në formë të inxhinjeringut të bërë nga një grup i personave që i përkasin apo kanë qenë të angazhuar kundërligjshëm për subjektin politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (më tej LDK) dhe

kësisoj, rezultatet me postë që adresohen vetëm për LDK-në, siç pretendojnë në ankesë se duhet të largohen nga rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për shkak se nga procesi i regjistrimit, mënyra e votimit, dërgimi me postë i fletëvotimeve, e deri të vendosja e rezultateve përfundimtare zgjedhore, siç do të argumentohet dhe provohet më poshtë, janë veprime kundër kushtetuese, kundërligjore dhe cenojnë rëndë integritetin e zgjedhjeve parlamentare në tërësi. Më tutje në ankesë theksohet se kjo formë e organizimit ka cenuar rëndë nenin 45 dhe nenin 7 të Kushtetutës, si dhe nenin 6 dhe 7 të LZP-së, duke cenuar të drejtën e qytetarëve për të votuar, konkretisht, provat e ofruara në këtë ankesë theksohet se dëshmojnë përtej dyshimit të bazuar se një grup personash kanë manipuluar me votën me postë, (1) qoftë përmes formës ku kanë votuar në emër të qytetarëve të cilët jetojnë jashtë vendit, për subjektin politik LDK dhe disa prej kandidatëve të saj, apo (2) qoftë përmes manipulimit të votës me postë brenda Kosovës, ku potencialisht ka pasur mundësi të bëhet shtimi i zarfeve me vota të manipuluar te kutitë e votave me postë. Sipas pretenduesit në ankesë ky grup i mirë organizuar ka cenuar parimin e votimit individual dhe të fshehtë të përcaktuar me nenin 45 dhe 7 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të LZP-së, dhe përmes veprimeve të tilla manipulative dhe të kundërligjshëm, është cenuar dhe minuar rëndë integriteti i procesit të votimit, i cili bie ndesh me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, por edhe me Kodin e Praktikës së mirë në Çështjet zgjedhore të Komisionit të Venecias.

Në vazhdim të ankesës theksohet se vërehet qartë nga një vrojtim i thjeshtë i fletëvotimeve të dërguara me postë nga jashtë vendit, si dhe dëshmitë e ofruara provojnë qartazi se, në një numër të madh fletëvotimesh të ndryshme, të ardhura me postë nga jashtë Kosovës vërehet se ka elemente të shumta që provojnë qartazi parregullsitë e evidentuara mbi mënyrën e plotësimit të fletëvotimeve, numrat e kandidatëve të shënjuar në mënyrë të përqendruar, formën e fletëvotimeve, formën e shënjitimit të fletëvotimeve e të cilat janë votime kolektive, të personave të tjerë në emër të votuesve që kanë jetuar apo jetojnë jashtë vendit. Andaj theksojnë se në qartësim të mëtejshëm të kësaj skeme vërehet qartë se forma e organizuar të votimit kolektiv është realizuar duke shënjuar në fletëvotime të printuara dhe fletëvotime të fotokopjuara, të shumta dhe të ndryshme, nga shenjat si në vijim: 0, U, V, X që do t'i bashkëngjiten kësaj ankesë. Po ashtu theksojnë se vërehet qartë se gjatë plotësimit të fletëvotimeve janë përdorë laps kimik i njëjtë, ngjyra e njëjtë, dhe duart e njëjta në formë të përsëritur, duke votuar për subjektin politik LDK dhe disa prej kandidatëve të saj me numër si vijon: Hysen Çekaj 80, Bahrije Hyseni 99, Alban Zogaj 22, Gazmend Muhaxheri 5, Jeta Rafuna Hasani 45 Fatmir Asllani 61, Qëndrim Softolli 73 dhe Berat Rukiqi 20.

Sipas pretendimeve në ankesë theksohet se duke u bazuar në parimet e votimit, në praktikat e votimit në të gjitha zgjedhjet, por edhe në këto zgjedhje është e kuptueshme që pavarësisht principeve ligjore mbi mënyrën e plotësimit të fletëvotimit, procesi i votimit është edhe akt autentik individual i dallueshëm në aspektin grafologjik për secilin votues, ku asnjë votues nuk vendos shenjën e votimit në mënyrë identike me votuesit e tjerë, siç ka ndodhur në procesin e votimit me postë në rastin konkret në këtë ankesë. Andaj, procesi spontan i votimit gjithsesi reflekton gjendjen autentike dhe kaligrafinë unike të votuesit.

Në pretendimet e lartpërmendura si provë janë bashkangjitur disa Fletëvotime të ardhura me postë.

Në vazhdim theksohet se votuesi Dardan Kemal Thaçi i datëlindjes 21/03/1991 me numër personal 1230187670, i lindur Runjevë, Komuna e Kaçanikut me vendbanim Shtutgart ka deklaruar se nuk ka votuar me postë në zgjedhjet e fundit parlamentare të mbajtura me 9 shkurt 2025, por emri dhe të dhënat e tij gjenden në listën votuese për votim jashtë vendit, respektivisht në listën e votimit me postë, dhe dyshohet për të dhëna për numrin (unik) të aplikimit që është i përsëritur shumë herë, megjithëse i njëjti mund të jepet vetëm një herë, të gjitha këto mund të konfirmohen nga të dhënat që disponon KQZ. Provat që i posedojnë vërehet qartë se shumë zarfe që janë dërguar nga jashtë përmes postës, janë të së njëjtës ngjyre, kanë pullë postare të njëjta, që njëkohësisht të dërgon përtej dyshimit të bazuar, se manipulimi dhe votimi në mënyrë kolektive nga subjekti politik LDK, dhe kandidatë të saj. Po ashtu, dyshohet për të dhëna për numrin (unik) të aplikimit që është i përsëritur shumë herë, megjithëse i njëjti mund të jepet veç një herë. Të gjitha këto mund të konfirmohen nga të dhënat që disponon KQZ.

I tërë ky argumentim logjiko - juridik, jep bazë të mjaftueshme që procesi i votimit me postë në tërësi, ka qenë i manipuluar në raport me votat të cilat i kanë shkuar subjektit politik LDK dhe kandidatëve të këtij subjekti dhe konsiderojnë se 18933 vota të subjektit politik LDK dhe kandidatëve të saj duhet të anulohen në tërësi dhe të largohen nga rezultatet përfundimtare të shpallura me vendimin Nr .01/727-2025, të datës 15.03.2025, të KQZ-së. Prandaj duke e dituar që në secilin fletëvotim të ardhur me postë ka pasur manipulime të tilla, është dëmtuar integriteti zgjedhor, është cenuar e drejta e votimit siç përcaktohet në Kushtetutë dhe Ligj, prandaj në bazë të nenit 119 dhe 120 të LZP-së, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, dhe paragrafi 3 nënparagrafi 3.2 ndërlidhur me nenet 101 dhe 106 të LZP-së, të ndërlidhur me nenin 13 paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 dhe 10.3, si dhe paragrafit 11 nënparagrafit 11.1 dhe 11.2 të Rregullores Zgjedhore Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-së, kërkojnë nga PZAP, që të anulojë rezultatet e votimit me postë për subjektin politik LDK dhe kandidatët e saj, gjithsej 18933 vota dhe këto vota të largohen nga rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, dhe njëkohësisht ta urdhërojë KQZ-në që të përsërisë votimin në tërësi si dhe t'i largojë nga lista e kandidatëve të subjektit politik LDK kandidatët, të cekur me emër e mbiemër në arsyetimin e kësaj Ankese, për shkak të manipulimit me vota të ardhura me postë dhe të mos e lejojë subjektin politik LDK t'i zëvendësojë kandidatët e larguar.

Në përgjigje në ankesë nga KQZ tregohen në mënyrë kronologjike periudha e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës e ku theksohet se pas përfundimit të periudhës së regjistrimit, shqyrtimi i aplikacioneve për regjistrim është bërë deri me datën 28 dhjetor në orën 15:55, rrjedhimisht KQZ ka pranuar kundërshtimet administrative për procesin e regjistrimit deri me date 29.12.2024 në ora 15:55. Gjatë periudhës së kundërshtimit, janë aprovuar 21 kërkesa për kundërshtim administrativ, të votuesve të cilët ishin refuzuar dhe të cilët janë aprovuar gjatë periudhës së regjistrimit, janë aprovuar po ashtu 151 kërkesa për anulimin e regjistrimit

dhe kthimin në listën e votuesve brenda Kosovës si dhe janë hedhur si të palejuara 179 kundërshtime. KQZ me datë 30 dhjetor 2024, ka marrë vendim për aprovimin e 137 kërkesave për kundërshtim të cilët kishin dërguar dëshmitë gjatë kundërshtimit, në mungesë të cilave ishin refuzuar gjatë shqyrtimit të aplikimeve për refuzim. I pakënaqur me vendimin e KQZ-së, një votues ka parashtruar ankesë në PZAP me datë 30.12.2024, dhe PZAP me datë 03.01.2025 ka marrë vendim për refuzimin e ankesës. KQZ, me datë 04.01.2025, me vendimin numër 01/19-2025, ka certifikuar Listën e Përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025, që janë mbajtur me datë 9 shkurt 2025. Lidhur me pretendimin ku thuhet shtetasi D.TH deklaroi se nuk ka votuar, ajo që mund të thuhet është se KQZ nuk publikon dhe nuk e vë në dispozicion listën e atyre që kanë votuar ose jo. I njëjtin shtetas ka aplikuar për regjistrim përmes email adresës dardan.thaqi69@gmail.com. KQZ në këtë email adresë i ka dërguar dëftesën e regjistrimit dhe fletëvotimin me udhëzimet për votim. Të dhënat dhe dëshmitë e regjistrimit janë bashkangjitur me këtë përgjigje, si provë 1. Gjatë vlerësimit të zarfeve me fletëvotime të pranuar përmes postës, rezultoi se i njëjti ka votuar dhe në zarf ka bashkangjitur dëftesën e regjistrimit të pranuar në email adresën dardan.thaqi69@gmail.com. Në vazhdim të përgjigjes së KQZ-së, theksohet se gjatë periudhës së votimit, nga kutia postare janë tërhequr gjithsej 68,715 zarfe. Më datë 9 shkurt 2025, ka filluar vlerësimi i zarfeve me fletëvotime dhe më 24 shkurt 2025 ka përfunduar procesi i vlerësimit të zarfeve. Nga gjithsej 68,712 zarfe të pranuar, 63,667 zarfe janë aprovuar (të gjitha zarfe të aprovuara kanë përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 18 të Rregullores Zgjedhore 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve), 4,898 zarfe janë refuzuar dhe 150 zarfe kanë mbërritur gabimisht në adresën e kutisë postare të KQZ-së. Ndërsa lidhur me pretendimet e ngritura në lidhje me parregullsitë e evidentuara mbi mënyrën e plotësimit të fletëvotimeve, specifikisht për sa i përket numrave të kandidatëve të shënjuar në mënyrë të përqendruar, formës së fletëvotimeve, si dhe formës së shënjitimit të fletëvotimeve, të cilat sipas parashtruesit të ankesës mund të ngjasojnë me votimin kolektiv të personave të tjerë në emër të votuesve dhe jo me votimin individual, dëshirojmë të sqarojmë se, sipas nenit 16 të Rregullores Nr. 12/2024, i cili rregullon "Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Vendvotimit", një votë do të konsiderohet e vlefshme kur ajo është e shënjuar për vetëm një subjekt politik dhe ku qëllimi i votuesit është i qartë dhe i kuptueshëm.

PZAP pasi që shqyrtoj ankesën dhe përgjigjen në ankesë ka gjetur se:

- Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të ankesës se kanë identifikuar parregullsi lidhur me procesin e votimit përmes postës, PZAP-i, i vlerësoi të pabazuara. Parashtruesi i ankesës kërkon që të anulohet rezultati i votimit me postë të cilat i ka marrë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës dhe kandidatët e saj, ndërsa në raport me këto pretendime në ankesë me asnjë provë bindëse nuk i ka dëshmuar se mbi cilat shkaqe e kërkon një gjë të tillë, pasi që anulimi i rezultatit të votimit me postë dhe përsëritja e votimit me postë duhet të mbështetet në dëshmi të qarta për manipulim, qoftë me rastin e dorëzimit, apo me rastin e numërimit, e të cilat

shkaqe parashtruesi i ankesës ka dështuar që ti argumenton. Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e tillë të parashtruar e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit të ankesës se në listën e votuesve jashtë vendit janë të regjistruar persona me e-mail adresa që janë përdorur shumë herë, gjegjësisht ka pasur parregullsi gjatë regjistrimit të tyre, Paneli gjeti se ky pretendim ankimor nuk qëndron për faktin se sipas procedurave standarde të veprimit për regjistrimin dhe votimin jashtë Kosovës si dhe vlerësimin e pakove me fletëvotime e cila procedurë parashihet kufizimin maksimal me katër kërkesa për regjistrim nga e njëjta e-mail adrese, andaj pas miratimit të procedurës Divizioni i TI zgjedhore në KQY ka bërë konfigurimin në sistemin elektronik dhe ka kufizuar përdorimin e një adrese e-mail jo më shumë se katër herë, por jo nga i njëjti person. Pra sipas kësaj procedure edhe nëse është tentuar të votohet me shumë se katër herë nga e njëjta e-mail adrese sipas këtij konfigurimi nuk i ka pranuar kërkesat e tilla.

Kështu që paneli ka gjetur se procesi i regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës ka kaluar nëpër disa faza, këta votues fillimisht kanë aplikuar në mënyrë të rregullt për tu regjistruar si votues jashtë Kosovës, me pastaj pranimit dhe evidentimit të kërkesave për regjistrim si dhe procesi i konfirmimit dhe kundërshtimit të listës së votuesve jashtë Kosovës nga ana e KQZ. Kështu që këta votues i kanë kaluar të gjitha këto faza të regjistrimit dhe kanë pasur dy mundësi për tu pajisur me fletëvotim: qoftë përmes e-mailit në adrese elektronike të cilën adresë e kanë dhënë votuesit gjatë periudhës për regjistrim ose duke e shkarkuar fletëvotimin nga web faqja e KQZ. Pastaj dërgimi i këtyre është bërë në dy forma: përmes dërgesës në kuti postare jashtë Kosovës ose përmes dërgimit në postë në Kosovë.

Andaj i gjithë ky proces, përkatësisht të gjitha dërgesat i janë nënshtruar verifikimit, observimit dhe konfirmimit të të gjitha dërgesave nga ana e KQZ-së. Andaj duke pas parasysh të lartcekurat konkludohet se ka qenë e lejuar të përdoret një e-mail adresë deri në katër herë, por jo nga personi i njëjtë, atëherë nuk mund të flitet për raste të orkestruara që kontaminojnë procesin e votimit.

Ndërsa sa i përket pretendimit tjetër ankimor se personi i quajtur Dardan Thaqi me të dhëna si në ankesë, se ky person edhe pse pretendon se nuk ka votuar emri i tij është gjendur në listën e atyre që kanë votuar. Paneli në bazë të provave të bashkangjitura ka gjetur se ky person ka aplikuar për regjistrim si votues jashtë Kosove përmes e-mail adresës dardan.thaqi69@gmail.com dhe nga ana e KQZ-së të njëjtit në këtë adresë i është dërguar dëftesa e regjistrimit dhe fletëvotimi me udhëzimet për votim, andaj në bazë të kësaj narrative nuk pasur mundësi që askush tjetër të votojë përmes e-mail-it e tij në emër të tij.

Sa i përket pretendimit ankimor se ka qenë një grup personash të cilët kanë manipuluar me votat e personave të cilët jetojnë jashtë vendit duke votuar në emër të këtyre personave dhe duke përdorur shenjat votimit : o, v, x, u, nga lapsi i njëjtë, ngjyra dhe dora e njëjtë, sipas panelit ky pretendim është vetëm supozim dhe i pa mbështetur në ndonjë provë konkrete që dëshmon këtë. Duhet pasur parasysh se kontestimet e tilla janë të natyrës së grafologjisë dhe

se për tu argumentuar si shkelje duhet që të ketë ekspertizë profesionale për të identifikuar se a është përdorë nga i njëjti person ngjyra dhe lapsi i njëjtë në vënien e shenjës në fletëvotim. Ky është pretendim i ngritur nga pala ankuese është i pa bazuar pasi që, barra e provës për faktet të pretenduara bie pikërisht mbi palën që ngrit pretendime të tilla. Roli i PZAP është që të bëjë vlerësim administrativ për të siguruar që procedurat zgjedhore të respektohen, ndërsa nuk ka autoriteti që të vlerësoj në aspektin grafologjik shenjat e përdorura në fletëvotim.

Sipas Paneli, një fletëvotim konsiderohet i vlefshëm nëse cilado nga këto shenja është vendosur brenda katrorit të subjektit apo kandidatit, me rëndësi ka qenë që qëllimi i votuesit të jetë i qartë, përkatësisht është votuar konform nenit 16 të rregullores 12/24 që rregullon vlefshmërinë e fletëvotimit dhe votës ku neni 16 par.2 shprehimisht parasheh se *“Vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit”*. Ndërsa sa i përket pretendimit se është përdorur lapsi i njëjtë dhe dora e njëjtë ky pretendim ankimor mbetet vetëm në nivel të supozimit dhe hipotezës, e po ashtu për të njëjtin pretendim nuk është bashkangjitur asnjë provë konkrete.

Përfundimisht, PZAP vlerëson se pretendimet në ankesë janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova për t'i vërtetuar pretendimet ankimore, edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, ndërsa pretendimet e përgjithshme e të pa mbështetura në prova relevante mbesin pretendime hipotetike dhe nuk mundë të vërtetohen në këtë procedurë.

Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

A.nr. 641/2025 më datën 19.03.2025

Kryesuesi i Panelit,

Arsim Hamzaj




KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME



AA.nr.62/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani kryetar, Rrustem Thaqi dhe Lumni Sallauka anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.641/2025, të datës 19.03.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09.02.2025, në seancën e mbajtur më datë 25.03.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.641/2025, të datës 19.03.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.641/2025, të datës 19.03.2025, është vendosur: REFUZOHET e pabazuar ankesa A.nr.641/2025, të datës 17.03.2025 e subjektit politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/727-2025, të datës 15 Mars 2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, me të cilën ka kërkuar që të anulohen rezultatet e votimit me postë për subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës dhe kandidatët e saj, gjithsej 18933 vota dhe këto vota të largohen nga rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, ta urdhërojë KQZ-në që të përsërisë votimin me postë në tërësi si dhe ti largoj nga lista e kandidatëve të subjektit politik LDK kandidatët të cekur me emër e mbiemër në arsyetimin e kësaj ankesë, për shkak të manipulimit me vota të ardhura me postë dhe të mos e lejojë subjektin politik LDK ti zëvendësoj kandidatët e larguar.

Kundër këtij vendimi, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij për shkak se: vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LVV-së, duke vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljes së të drejtës materiale duke



propozuar që të: I. APROVOHET ankesa e subjektit politik LVV, parashtruar pranë kësaj gjykate më datë 19.03.2025, II. ANULOHEN rezultatet e votimit me postë për subjektin politik LDK dhe kandidatët e saj, gjithsej 18933 vota dhe këto vota të largohen nga rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, III) Të urdhërojë KQZ-në që të përsërisë votimin me postë dhe IV) Të urdhërojë PZAP që të largoj nga lista kandidatët e subjektit politik LDK, të cekura me emër e mbiemër në arsyetimin e kësaj ankese, për shkak të manipulimit me vota të ardhura me postë dhe të mos e lejojë subjektin politik LDK ti zëvendësoj kandidatët e larguar.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore duke shtuar se mbeten në tërësi pranë vendimit të kundërshtuar, i cili është në tërësi në pajtim me Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe propozon që ankesa e subjektit politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi Anr.641/2025, të datës 19.03.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 17.03.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën me numër Anr.641/2025, nga subjekti politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, nr.01/727-2025, të datës 15.03.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09.02.2025.

Më datë 17.03.2025, PZAP-i, njoftoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur më datë 18.03.2025, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), theksohet se: Periudha e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të mbajtura më datë 9 shkurt 2025, ka filluar më datë 29 gusht 2024 dhe ka përfunduar më datë 26 dhjetor 2024. Shtetasit me të drejtë vote që jetojnë jashtë Kosovës, mund të aplikojnë për regjistrim si votues jashtë Kosovës përmes platformës elektronike për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës (<https://diaspora.kqz-ks.org>) dhe duke dërguar kërkesën për regjistrim përmes postës, në kutinë postare të KQZ, në Prishtinë. Përgjatë kësaj periudhe të regjistrimit Divizioni për Shërbim Votues (DSHV) ka shqyrtuar 124,170 kërkesa për regjistrim për votim jashtë Kosovës, kërkesat janë shqyrtuar në pajtim me kriteret e përcaktuara në Rregulloren Zgjedhore nr.17/2024 për regjistrim dhe Votimin jashtë Kosovës. Përgjatë periudhës së regjistrimit është vërejtur përdorimi i të njëjtës email adresë nga persona të ndryshëm. Andaj, më datë 11 dhjetor 2024, KQZ ka miratuar Procedurat Standarde të Veprimit për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës si dhe vlerësimin e Pakove me Fletëvotime, e cila parasheh kufizimin maksimal prej 4 (katër kërkesa për regjistrim nga e njëjta email adresë për një person). Për adresë email, për të cilën janë bërë konfigurimet e nevojshme nga Divizioni i Të Dërguarve të DSHV ka votuesit të cilët janë regjistruar para datës së nxjerrjes së Procedurave Standard.



bërë verifikimin e votuesve, votuesit janë kontaktuar përmes telefonit dhe është siguruar që ata posedojnë dëftesën e regjistrimit, si dhe janë kërkuar të dhënat për verifikim me ç'rast DSHV, ka bërë aprovimin e kërkesave apo të njëjtat i ka anuluar. Lidhur me përdorimin e numrit unik ka theksuar se DSHV ka verifikuar këto të dhëna edhe me të dhënat e tjera personale, ndërsa përdorimit të numrit të telefonit ka theksuar se rregullorja nuk ka përcaktuar ndonjë kufizim sa i përket numrit të telefonit, për votuesit jashtë Kosovës.

Tutje theksohet se, pas përfundimit të periudhës së regjistrimit, shqyrtimi i aplikacioneve për regjistrim është bërë deri më datën 28 dhjetor në orën 15:55, rrethmish KQZ ka pranuar kundërshtimet administrative për procesin e regjistrimit deri më datë 29.12.2024 në ora 15:55. Gjatë periudhës së kundërshtimit, janë aprovuar 21 kërkesa për kundërshtim administrativ të votuesve, të cilët ishin refuzuar dhe të cilët janë aprovuar gjatë periudhës së regjistrimit, janë aprovuar po ashtu 151 kërkesa për anulimin e regjistrimit dhe kthimin në listën e votuesve brenda Kosovës si dhe janë hedhur si të palejuara 179 kundërshtime. KQZ më datë 30 dhjetor 2024, ka marrë vendim për aprovimin e 137 kërkesave për kundërshtim të cilat kishin dërguar dëshmitë gjatë kundërshtimit, në mungesë të cilave ishin refuzuar gjatë shqyrtimit të aplikimeve për refuzim. I pakënaqur me vendimin e KQZ-së, një votues ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 30.12.2024, dhe PZAP më datë 03.01.2025 ka marrë vendim për refuzimin e ankesës. KQZ, më datë 04.01.2025, me vendimin numër 01/19-2025, ka certifikuar Listën e Përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025, që janë mbajtur më datë 9 shkurt 2025.

Lidhur me pretendimin ku thuhet shtetasi D.TH deklaron se nuk ka votuar, ajo që mund të thuhet është se KQZ nuk publikon dhe nuk e vë në dispozicion listën e atyre që kanë votuar ose jo. I njëjtin shtetas ka aplikuar për regjistrim përmes email adresës. KQZ në këtë email adresë i ka dërguar dëftesën e regjistrimit dhe fletëvotimin me udhëzimet për votim. Të dhënat dhe dëshmitë e regjistrimit janë bashkangjitur me këtë përgjigje, si provë 1. Gjatë vlerësimit të zarfeve me fletëvotime të pranuar përmes postës, rezulton se i njëjti ka votuar dhe në zarf ka bashkangjitur dëftesën e regjistrimit të pranuar në email adresën dardan.thaqi69@gmail.com. Në vazhdim të përgjigjes së KQZ-së, theksohet se gjatë periudhës së votimit, nga kutia postare janë tërhequr gjithsej 68,715 zarfe. Më datë 9 shkurt 2025, ka filluar vlerësimi i zarfeve me fletëvotime dhe me 24 shkurt 2025 ka përfunduar procesi i vlerësimit të zarfeve. Nga gjithsej 68,712 zarfe të pranuar, 63,667 zarfe janë aprovuar (të gjitha zarfe të aprovuara kanë përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 18 të Rregullores Zgjedhore 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve), 4,898 zarfe janë refuzuar dhe 150 zarfe kanë mbërritur gabimisht në adresën e kutisë postare të KQZ-së. Ndërsa lidhur me pretendimet e ngritura në lidhje me parregullsitë e evidentuara mbi mënyrën e plotësimit të fletëvotimeve, specifikisht për sa i përket numrave të kandidatëve të shënjuar në mënyrë të përqendruar, formës së fletëvotimeve, si dhe formës së shënimit të fletëvotimeve, të cilat sipas parashtruesit të ankesës mund të ngjasojnë me votimin kolektiv të personave të tjerë në emër të votuesve dhe jo me votimin individual, dëshirojmë të sqarojmë se, sipas nenit 16 të Rregullores Nr. 12/2024, i cili rregullon "Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Vendvotimit", një vote do të konsiderohet e vlefshme kur ajo është e shënjuar për vetëm një subjekt politik dhe kur çelësi i votuesit është i qartë dhe i kuptueshëm.



PZAP, pasi që shqyrtoj pretendimet në ankesë të LVV, përgjigjen në ankesë të KQZ si dhe të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragraf 3 të LZP-së, konstatoi se ankesa është e pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të saj.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Pretendimet e parashtruesit të ankesës se kanë identifikuar parregullsi lidhur me procesin e votimit përmes postës, PZAP-i, i vlerësoi të pabazuara. Parashtruesi i ankesës kërkon që të anulohet rezultati i votimit me postë të cilat i ka marrë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës dhe kandidatët e saj, ndërsa në raport me këto pretendime në ankesë me asnjë prove bindëse nuk i ka dëshmuar se mbi cilat shkaqe e kërkon një gjë të tillë, pasi që anulimi i rezultatit të votimit me postë dhe përsëritja e votimit me postë duhet të mbështetet në dëshmi të qarta për manipulim, qoftë me rastin e dorëzimit, apo me rastin e numërimit, e të cilat shkaqe parashtruesi i ankesës ka dështuar që ti argumenton. Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e tillë të parashtruar e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Lidhur me pretendimet ankimore të subjektit politik ankues theksohet se: Pretendimet e parashtruesit të ankesës se në listën e votuesve jashtë vendit janë të regjistruar persona me e-mail adresa që janë përdorur shumë herë, gjegjësisht ka pasur parregullsi gjatë regjistrimit të tyre, Paneli gjeti se ky pretendim ankimor nuk qëndron për faktin se sipas procedurave standarde të veprimit për regjistrimin dhe votimin jashtë Kosovës si dhe vlerësimin e pakove me fletëvotime e cila procedurë parashihet kufizimin maksimal me katër kërkesa për regjistrim nga e njëjta e-mail adresë, andaj pas miratimit të procedurës Divizioni i teknologjisë Informative Zgjedhore, në KQZ, ka bërë konfigurimin në sistemin elektronik dhe ka kufizuar përdorimin e një adresë e-mail jo më shumë se katër herë, por jo nga i njëjti person. Pra sipas kësaj procedure edhe nëse është tentuar të votohet më shumë se katër herë nga e njëjta e-mail adresë sipas këtij konfigurimi nuk i ka pranuar kërkesat e tilla. Kështu, paneli ka gjetur se procesi i regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës ka kaluar nëpër disa faza, këta votues fillimisht kanë aplikuar në mënyrë të rregullt për tu regjistruar si votues jashtë Kosovës, me pastaj pranimit dhe evidentimit të kërkesave për regjistrim si dhe procesi i konfirmimit dhe kundërshtimit të listës së votuesve jashtë Kosovës nga ana e KQZ. Kështu që këta votues i kanë kaluar të gjitha këto faza të regjistrimit dhe kanë pasur dy mundësi për tu pajisur me fletëvotim: qoftë përmes e-mailit në adresën elektronike të cilën adresë e kanë dhënë votuesit gjatë periudhës për regjistrim ose duke e shkarkuar fletëvotimin nga web faqja e KQZ. Pastaj dërgimi i këtyre është bërë në dy forma: përmes dërgesës në kuti postare jashtë Kosovës ose përmes dërgimit në postë në Kosovë. Andaj i gjithë ky proces, përkatësisht të gjitha dërgesat i janë nënshtruar verifikimit, observimit dhe konfirmimit të gjitha dërgesave nga ana e KQZ-së. Andaj duke pas parasysh të lartcekurat konkludohet se ka qenë e lejuar të përdoret një e-mail adresë deri në katër herë, por jo nga personi i njëjtë, atëherë nuk mund të flitet për raste të orkestruara që kontaminojnë procesin e votimit.

Ndërsa sa i përket pretendimit tjetër ankimor se personi i quajtur me të dhëna... në ankesë, se ky person edhe pse pretendon se nuk ka votuar emri i tij është gjendur në listën e votuesve atyre që kanë e votuar. Paneli në bazë të provave të bashkëngjitura ka gjetur se ky person ka



aplikuar për regjistrim si votues jashtë Kosovës përmes e-mail adresës, dhe nga ana e KQZ-së të njëjtit në këtë adresë i është dërguar dëftesa e regjistrimit dhe fletëvotimi me udhëzimet për votim, andaj në bazë të kësaj narrative nuk pasur mundësi që askush tjetër të votoj përmes e-mail-it e tij në emër të tij. Sa i përket pretendimit ankimor se ka qenë një grup personash të cilat kanë manipuluar me votat e personave të cilët jetojnë jashtë vendit duke votuar në emër të këtyre personave dhe duke përdorur shenjat e votimit : 0, V, X, U, nga lapsi i njëjtë, ngjyra dhe dora e njëjtë, sipas panelit ky pretendim është vetëm supozim dhe i pa mbështetur në ndonjë provë konkrete që dëshmon këtë. Duhet pasur parasysh se kontestimet e tilla janë të natyrës së grafologjisë dhe se për tu argumentuar si shkelje duhet që të ketë ekspertizë profesionale për të identifikuar se a është përdorë nga i njëjti person ngjyra dhe lapsi i njëjtë në vënien e shenjës në fletëvotim. Ky pretendim i ngritur nga pala ankuese është i pa bazuar pasi që, barra e provës për faktet të pretenduara bie pikërisht mbi palën që ngrit pretendime të tilla. Roli i PZAP është që të bëjë vlerësim administrativ për të siguruar që procedurat zgjedhore të respektohen, ndërsa nuk ka autoriteti që të vlerësojë në aspektin grafologjik shenjat e përdorura në fletëvotim.

Sipas Panelit, një fletëvotim konsiderohet i vlefshëm nëse cilado nga këto shenja është vendosur brenda katorrit të subjektit apo kandidatit, me rëndësi ka qenë që qëllimi i votuesit të jetë i qartë, përkatësisht është votuar konform nenit 16 të rregullores 12/24 që rregullon vlefshmërinë e fletëvotimit dhe votës ku neni 16 paragraf 2 shprehimisht parasheh se: *“Vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit”*. Ndërsa sa i përket pretendimit se është përdorur lapsi i njëjtë dhe dora e njëjtë ky pretendim ankimor mbetet vetëm në nivel të supozimit dhe hipotezës, e po ashtu për të njëjtin pretendim nuk është bashkangjitur asnjë provë konkrete. Përfundimisht, PZAP vlerëson se pretendimet në ankesë janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova për t’i vërtetuar pretendimet ankimore, edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, ndërsa pretendimet e përgjithshme e të pa mbështetura në prova relevante mbesin pretendime hipotetike dhe nuk mund të vërtetohen në këtë procedurë. Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e datës 17.03.2025, të parashtruar nga subjekti politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09.02.2025. Vendimi i PZAP është i qartë, i drejtë, i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore nga neni 7 paragraf 4, neni 97 paragraf 1, nën-paragraf 1.1, 2 dhe 3, të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 3 paragraf 3, 3.2, 3.3, 3.3.1, 3.3.2, 3.4 të Rregullores nr.17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës, neni 18 të Rregullores Zgjedhore nr.14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, neni 16 të Rregullores nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit si dhe Procedurat



Standarde të Veprimit për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës si dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kolegji i kësaj gjykate vlerësoj se pretendimet kryesore të ankuesit i referohen: i) manipulimit të mundshëm të votave, fillimisht me rastin e regjistrimit me përdorimin e të njëjtës email adresë nga persona të ndryshëm, ii) shkeljeve të procedurave të identifikimit dhe verifikimit të votuesve, përkatësisht përsëritjes së numrit unik të regjistrimit për aplikues të ndryshëm, dhe më të njëjtin numër kontaktues të telefonit iii) manipulim i votës së personit, i cili ka deklaruar se nuk ka votuar me postë, iv) dërgesave postare dhe fletëvotimeve, përkatësisht shënjimeve të fletëvotimeve, fotoprintimeve apo fotokopjimeve të tyre, si: lapsit kimik dhe ngjyrës së njëjtë, zarfeve me ngjyrë dhe pullës postare të njëjtë.

Pretendimet ankimore të lartcekura, të theksuar dhe elaboruara më gjerësisht edhe në ankesë, kolegji i kësaj gjykate i ka shqyrtuar me vëmendje dhe kujdes të veçantë, megjithatë të njëjtat i ka refuzuar si të paqëndrueshme dhe të pabazuara, për faktin se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura ligjore si dhe ankuesi të njëjtat pretendime ankimore i ka parashtruar edhe pranë PZAP-së, me ç'rast edhe arsyetimi i tyre është konsumuar me vendimin e atakuar. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, përcaktuese për ligjshmërinë e vendimit të PZAP-së, është fakti se ankuesi ka parashtruar pretendime të paprovuara për manipulimin e votave. Gjykata, nuk ka mundur që me asnjërin nga provat e ofruara nga ankuesi, të vërtetojë pretendimet ankimore lidhur me cenimin e të drejtës së votimit, apo shkeljes së nenit 6 dhe 7 të LZP-së, nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, siç thekson ankuesi në ankesën e tij. Ndërsa provat e parashtruara, janë të pathemelta, sepse çdo pretendim për manipulimin e votave duhet të provohet në masë të besueshme për të krijuar bazë për rinumërim, anulim apo përsëritje të rinumërimit, apo edhe për një vendim tjetër, prandaj në këtë rast këto pretendime janë pa ndikim për të vendosur ndryshe. Provat e bashkëngjitura në ankesë, nuk provojnë në mënyrë të besueshme manipulimin e rezultatit të subjektit politik Lidhja demokratike e Kosovës (LDK) apo/dhe kandidatëve të saj, dhe nuk përbën shkak për të urdhëruar anulimin e votimit me postë (gjithsej 18933 vota), përsëritjen e votimit me postë në tërësi apo të urdhëroj PZAP që të largoj nga lista kandidatët e subjektit politik, me të dhënat personale si në ankesë.

Në përmbledhje të argumenteve mbi pretendimet e tij, subjekti ankues ka arsyetuar se PZAP, me vendimin kontestues nuk ka shqyrtuar pretendimet, provat dhe dëshmitë e ofruara konform nenit 119 të LZP-së, ku ka pretenduar se: PZAP nuk ka dhënë arsyetimin e nevojshëm lidhur me pretendimin e përdorimit të email-it të njëjtë nga persona të ndryshëm përgjatë periudhës së regjistrimit për votim jashtë Kosovës, e cila ka filluar më datë 29 gusht 2024, përkatësisht para datës së nxjerrjes së Procedurave Standarde të Veprimit për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës (miratuar më 11 dhjetor 2024 nga KQZ), nga e cila datë ka filluar të zbatohet kufizimi maksimal prej prej 4 (katër) kërkesa për regjistrim nga e njëjta email adresë), megjithatë këtë pretendim kolegji i kësaj gjykate e ka refuzuar në tërësi si të pathemeltë dhe të paqëndrueshëm. Gjykata Supreme ka vlerësuar se, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - DPK i Teknologjisë Informative Zgjedhore, ka bërë konfigurimet e nevojshme për votimin me postë të cilët



janë regjistruar para datës së miratimit të nxjerrjes së Procedurave Standarde të Veprimit për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës, të datës 11 dhjetor 2024, përkatësisht ka bërë verifikimin e aplikues-ve të regjistruar, përmes kontaktimit me telefon dhe sigurimit që ata posedojnë dëftesën e regjistrimit, si dhe përputhshmërisë së të dhënave të kërkuara përgjatë kontaktimit me telefon me të dhënat e regjistruara, dhe vetëm pas sigurimit dhe verifikimit të saktë të aplikuesit, Divizioni për Shërbim Votues (DSHV) ka bërë aprovimin e kërkesave apo të njëjtat i ka anuluar.

Gjykata Supreme ka refuzuar edhe pretendimet lidhur me përdorimin e numrit të njëjti unik, ngase DSHV pasi ka vërejtur gabimin teknik, i ka verifikuar këto të dhëna edhe me të dhënat e tjera personale, dhe pas përfundimit të periudhës së regjistrimit, KQZ ka pranuar dhe shqyrtuar kërkesat për kundërshtimet administrative për procesin e regjistrimit deri më datë 29.12.2024, ndërsa më datë 04.01.2025 ka certifikuar Listën e Përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025, ndërsa pretendimet lidhur me përdorimin e numrit të njëjti të telefonit, drejtë është konstatuar nga PZAP ngase një kriter i tillë nuk është përcaktuar as me rregulloret dhe as me procedurat e zbatueshme për votuesit jashtë Kosovës. Po ashtu, lidhur me pretendimin ku thuhet shtetasi D.TH deklaron se nuk ka votuar, nga shkresat e lëndës shihet se KQZ në email adresën e tij, i ka dërguar dëftesën e regjistrimit dhe fletëvotimin me udhëzimet për votim, nga të cilat ka rezultuar se i njëjti ka votuar dhe në zarf ka bashkangjitur dëftesën e regjistrimit të pranuar në email adresën e njëjti.

Si rrjedhojë, sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme, nuk janë të bazuara dhe të qëndrueshme pretendimet ankimore lidhur me manipulimin e votave sipas dërgesave postare apo fletëvotimeve. Nga shkresat e lëndës, rezulton se KQZ ka bërë vlerësimin e zarfeve me fletëvotime, prej të cilave 63,667 zarfe janë aprovuar pasi ka rezultuar se të njëjtat i kanë përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 18 të Rregullores Zgjedhore 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, ku përcaktohet se: *“4. Dërgesa postare me fletëvotim është e vlefshme, nëse është individuale dhe është dërguar nga personi i cili figuron në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe përmban: 4.1. pullën dhe vulën postare të shtetit ku votuesi jeton; 4.2. zarfin e fshehtësisë; 4.3. dëftesën e regjistrimit e cila gjenerohet nga platforma elektronike. 5. Në rast të mos përmbushjes së njëres nga këto kriteret të përcaktuara në paragrafin 4, zarfi me fletëvotim konsiderohet i pavlefshëm dhe refuzohet.”* Ndërsa lidhur me pretendimet e ngritura në lidhje me parregullsitë e evidentuara mbi mënyrën e plotësimit të fletëvotimeve, formës së fletëvotimeve, si dhe shënimit të fletëvotimeve, të cilat pretendime e vënë në dyshim autenticitetin e votimit individual dhe fshehtësinë e tij, Kolegji i kësaj gjykate e ka refuzuar të pabazuar ngase drejtë është konstatuar se sipas nenit 16 të Rregullores Nr. 12/2024, për Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Vendvotimit”, ku përcaktohet se: *2. Vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit”*.

Subjekti politik ankues, ka paraqitur gjithashtu pretendime lidhur me shkeljen e parimit të integritetit të procesit zgjedhor, trendin e rritjes së numrit të votave me postë për kandidatët e cekur si në ankesë që ka ardhur si rezultat i votimit kolektiv, dhe që kundërligjshëm ka mundësuar që disa kandidatë nga radhët e subjektit politik LDK, të bëhen deputetë dhe



dështimit të PZAP për të shqyrtuar pretendimet ankimore përmes formimit të komisionit hetimor apo/dhe nxjerrjes së provës përmes ekspertizës grafologjike, për të vërtetuar shkeljet që ka ngritur ankuesi, të cilat cenojnë të drejtat kushtetuese dhe integritetin e një procesi zgjedhor të drejtë dhe transparent. Megjithatë, kolegji i kësaj gjykate ka shqyrtuar provat e parashtruara nga subjekti ankues dhe ka arritur në përfundimin se ato nuk janë të mjaftueshme për të konfirmuar manipulimin e votimit apo individët përgjegjës për ndonjë veprim të jashtëligjshëm gjatë regjistrimit të votuesve. Dëshmitë e ofruara, edhe pse sugjerojnë mundësinë e manipulimeve, nuk përmbajnë informacione të mjaftueshme dhe të qarta që mund të provojnë se procesi i regjistrimit dhe i votimit përmes postës, është i përfshirë në veprimet të kundërligjshme. Përveç kësaj, është vlerësim i kësaj gjykate se nuk është në mandatin e PZAP që të formojë komision hetimor dhe të caktoj nxjerrjen e ekspertizës grafologjike për hetimin e shkeljeve të pretenduara nga ankuesi, të cilat më shumë janë të natyrës penale, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me vlerësimin e integritetit të procesit zgjedhor, ndërsa pretendimet e tilla pala ankuese eventualisht mund ti adresojë tek organet e ndjekjes penale. Po ashtu, nuk është as në kompetencë të Gjykatës Supreme të nxjerr apo administrojë prova sipas mjeteve të goditjes, për arsye se kjo gjykatë vendos vetëm në bazë të provave dhe shkresave të lëndës. Përveç kësaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, rregullat e regjistrimit janë respektuar dhe procesi i verifikimit i KQZ-së ka siguruar që çdo aplikim të jetë i ligjshëm dhe i bazuar në informacion të saktë, andaj në këto kushte, kërkesa e subjektit politik ankues është refuzuar.

Gjykata Supreme ka vlerësuar se, përveç rregullave të veçanta për procesin zgjedhor, është e rëndësishme të respektohen parimet kushtetuese dhe të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtën e qytetarëve për të votuar. Në këtë kontekst, edhe pse ka pasur disa pretendime për shkelje të mundshme, nuk është provuar se procesi zgjedhor ka ndodhur në mënyrë të paligjshme ose që ka cenuar të drejtat e qytetarëve për të ushtruar votën e tyre.

Në këtë kontekst Gjykata Supreme e pranon në tërësi arsyetimin e dhënë nga PZAP, lidhur me mungesën e provave për të bazuar pretendimet e parashtruara dhe lidhur me referencat ligjore për bazën e refuzimit të ankimit të parashtruar në PZAP, në këtë rast me referencë në nenin 117 paragraf 3 dhe 118 paragraf 1 të LZP-së

Nga gjendja si më lartë me pretendimet ankimore, me asnjë provë nuk ka vihet në dyshim gjendja faktike e vërtetuar si më lartë nga ana e organit, vendimi i të cilit është kontestuar, andaj si të pa bazuara vlerësohen pretendimet e ankuesit në ankesë, përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

AA.nr.62/2025, më datë 25.03.2025



Republika e Kosovës



Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

8

Rugëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

Kryetar i kolegjit,
Ragip Namani



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



SEKRETARJATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-69/2025

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZALICNO DOSTAVLANJE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi I sa pas lehtës së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fëmijë, personit që punon për atë vend me marrësin.

1. Posto prinnilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni pošte ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odaslom članu domaćin. Prinaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në puntë marrësi).

2. Posto prinnilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom, mestu primaoca (prihitno na vratima stana odnosno prostorije gde prinnilac zaposlen)

Më _____ në ora _____ cas.
dana _____ u _____

Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog arbjavanja prijmaea

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

Emri i shkresës që dorëzohet:
Nasloj pisma koja se dostavlja:

AKTIVIRANJE

25.03.2025

Numri i shkojcave: _____
broj priloga _____

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
me (me fjalë)
Povrdjuemo prijem gorनावegengog pisma
(i slovima)

AA-69/2025

Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu) 694
1530

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesit, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je prinnilac nepismen ili nije u stanju da se potpise, potpisuje ga dostaljac, napomenom zasto prinnilac nije stavio svoj potpis.

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrtati)